



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial
Council

KPK/Nr. 291/2025
Datë: 30 prill 2025

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr. 06/L - 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 12 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe në bazë të nenit 10 paragrafi 4 të Rregullores Nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, në takimin e mbajtur më datë 30 prill 2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Hedhet si jo substanciale kërkesa për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj [REDACTED] prokuror në Departamentin e Krimeve të Rënda të Prokurorisë Themelore në Pejë, e parashtruar nga Autoriteti Kompetent, përkatësisht Kryeprokurorja e Prokurorisë Themelore në Pejë, znj. Lumturije Vuçetaj.

ARSYETIM

Këshilli Prokurorial i Kosovës, (më tutje Këshilli) me datë 23 prill 2025, nga autoriteti kompetent, ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimeve disiplinore, me numër AD.Nr.05/2025, ndaj [REDACTED] prokuror në Prokurorinë Themelore në Pejë, pasi që i njëjti supozohet të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 6, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, lidhur me paragrafin 2, nënparagrafin 2.1 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe ka propozuar t'i shqiptohet sanksioni disiplinor "vërejtje jopublike me shkrim".

Autoriteti Kompetent, në kërkesën e paraqitur me datë 23 prill 2025, pretendon se prokurori në fjalë nuk i ka ushtruar funksionet prokuroriale brenda afateve kohore të parapara me ligj, ashtu që aktakuzën nën shenjë [REDACTED], kundër të pandehurve [REDACTED] dhe [REDACTED], e ka ngritur pas përfundimit të afatit kohor të hetimeve, në kundërshtim me nenin 156, paragrafi 3 dhe nenin 234, paragrafi 4 të KPPRK-së.

Këshilli, në takimin e mbajtur me 30 prill 2025, pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për fillimin e hetimeve disiplinore, ankesës së parashtruar në Gjykatën e Apelit së bashku me përkrahjen e Prokurorisë së Apelit, si dhe kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, lidhur me rastin konkret, konsideron se kërkesa për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj prokurorit të lartcekur është jo substanciale dhe nuk ka lidhje me shkeljen disiplinore.

Nga se u tha me lartë, konform nenit 12, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Ti dërgohet:

- Znj. Lunturije Vuçetaj, Kryeprokurore e PTH Pejë;
- [Redacted], Prokuror në PTH Pejë;
- Arkivit të KPK -së.